




Platforma Regjionale e Ballkanit Perëndimor për Avokim të
Lirisë së Medieve dhe Sigurisë së Gazetarëve
Western Balkan's Regional Platform for Advocating
Media Freedom and Journalists' Safety

KOSOVA **Treguesit për** **nivelin e lirisë** **së medieve** **dhe sigurisë së** **gazetarëve** **2018.**



KOSOVA
Treguesit për
nivelin e lirisë
së medieeve
dhe sigurisë së
gazetarëve

Autori:
Petrit Çollaku
Dhjetor 2018.

Titulli origjinal

KOSOVA Treguesit për nivelin e lirisë së medieeve dhe sigurisë së gazetarëve 2018

Botuesi

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës



Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
Association of Journalists of Kosovo

Autori

Petrit Çollaku

Lektura

Arsim Halili

Dizajni

Lavi studio - Montenegro

Ky publikim është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Europian dhe Mbretërisë së Holandës. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës dhe autorit të publikimit, dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet që reflekton pozicionin e Bashkimit Europian ose Mbretërisë së Holandës.



This project is funded by
The European Union



Kingdom of the Netherlands

Përmbledhja ekzekutive	5	B Pozicioni i gazetarëve në redaksi, etika profesionale dhe niveli i censurës	14
Treguesit	5	B.1 A abuzohet me pozitën ekonomike të gazetarëve për të kufizuar lirinë e tyre?	14
A Mbrojtja ligjore e lirive të medieve dhe gazetarëve	8	B.2 Cili është niveli i pavarësisë editoriale nga pronarët e medieve dhe strukturat udhëheqëse?	15
A.1 A siguron legjisllacioni kombëtar garanci për lirinë e medieve dhe a zbatohet me efikasitet në praktikë?	8	B.3 Cili është niveli i pavarësisë editoriale të gazetarëve në RTK?	15
A.2 A shkakton ligji i shpifjes një efekt shqetësues mes gazetarëve?	10	B.4 Cili është niveli i pavarësisë editoriale të gazetarëve në sektorin jo-fitimprurës?	16
A.3 A ka mbrojtje të mjaftueshme ligjore të pluralizmit politik në medie para dhe gjatë fushatave zgjedhore?	11	B.5 Sa liri kanë gazetarët në procesin e prodhimit të lajmeve?	16
A.4 A është liria e punës dhe asociimit të gazetarëve e garantuar dhe e zbatuar në praktikë??	12	C Siguria e gazetarëve	17
A.5 Cili është niveli i mbrojtjes ligjore të burimeve të gazetarëve?	13	C.1 Statistikat e sigurisë dhe pandëshkueshmërisë	17
A.6 Cili është niveli i mbrojtjes së të drejtës për qasje në informata?	13	C.2 A mbajnë përgjegjësi institucionet shtetërore dhe aktorët politikë për mbrojtjen e gazetarëve?	18
		C.3 A i trajton me efektivitet sistemi i drejtësisë penale dhe civile, kërcënimet dhe aktet e dhunës kundër gazetarëve?	19
		Referencat dhe burimet	21
		Disclaimer and copyright	22

Përmbledhja e përgjithshme

Ky raport paraqet të gjeturat e hulumtimit të tretë të zhvilluar në kuadër të projektit rajonal Platforma Rajonale e Ballkanit Perëndimor për Avokim të Lirisë së Medieve dhe Sigurisë së Gazetarëve¹, të zbatuar nga asociacionet e gazetarëve në Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi. Raporti është vijueshmëri e studimit bazë², i cili ka paraqitur gjerësisht gjendjen e legjislacionit, çështjet socio-ekonomike dhe politike në lidhje me lirinë e medieve dhe sigurinë e gazetarëve si dhe ka identifikuar sfidat kryesore për asociacionet e gazetarëve dhe hisedarëve të tjerë. Qëllimi kryesor i këtij studimi kërkimor është zbulimi i zhvillimeve të reja dhe krahasimi me nivelet e lirisë së medieve dhe sigurisë së gazetarëve që janë identifikuar në vitin 2017.

Studimi kërkimor është kryer nga Petrit Çollaku sipas metodologjisë së përbashkët për 5 shtetet. Në vijim janë metodat e zbatuara për mbledhjen dhe analizën e të dhënave:

-
- ¹ Projekti është financuar nga Komisioni Evropian, në kuadër të Programi i Mediave dhe Shoqërisë Civile 2014-2015, Mbështetje për rrjetet rajonale tematike të Organizatave të Shoqërisë Civile.
 - ² Association of Kosovo Journalists, Indicators on the level of media freedom and journalists' safety 2016 Kosovo, (Pristina: AJK, 2016). Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, Treguesit e Lirisë së Mediave dhe Sigurisë së Gazetarëve 2016, <http://safejournalists.net/wp-content/uploads/2016/12/Raport-i-plot%C3%AB.pdf>

- Analiza cilësore e dokumenteve (ACD) e studi-meve hulumtuese dhe analizave të prodhuara nga organizata të tjera hulumtuese, akademike, OJQ, hulumtues individualë etj.; e dokumenteve zyrtare të prodhuara nga institucionet publike (aktet ligjore, nënligjore, strategjitë, raportet vjetore, procesverbalet nga mbledhjet, njoftimet për shtyp) dhe e mbulimit medietik (tekste, artikuj, raportet e lajmeve dhe materiale të tjera të publikuara).
- Intervistat cilësore me 7 gazetarë
- Të dhëna zyrtare statistikore të kërkuara nga institucionet publike ose të mbledhura nga faqet e internetit në dispozicion ose nga burime të tjera të botuara.

Treguesit A: Mbrojtja ligjore e lirive të medieve dhe gazetarëve

Në përgjithësi, Kushtetuta e Kosovës dhe korniza ligjore përmbledhin normat dhe garancitë kryesore që mbrojnë lirinë e medieve dhe shprehjes ndonëse zbatimi i tyre në praktikë është i dobët. Sa i përket legjislacionit për medie, në qershor të këtij viti, Komisioni parlamentar për medie ka miratuar, me vonesë projektligjin për Radiotelevizionin e Kosovës dhe tani është në shqyrtim nga deputetët e Kuvendit të Kosovës.

Sivjet, ky komision ka inicuar edhe hartimin e Ligjit për Medie, pa sqaruar qëllimin e hartimit të tij. Nisma është kritikuar nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, përfaqësuesit e medieve dhe organizatat joqeveritare që merren me këtë fushë, duke theksuar se iniciativa ka për qëllim ushtrimin e ndikimit dhe kontrollit të politikës mbi mediet, veçanërisht 'në disiplinimin e portaleve'. (Seksioni A.1)

Autoriteti rregullativ perceptohet të funksionojë në mënyrë efikase. Sidoqoftë, procesi zgjedhor i bordit drejtues të Komisionit të Pavarur të Mediave nga Kuvendi i Kosovës shihet si shkelje e pavarësisë së tij. (Seksioni A.1)

Praktika e reklamimit të shtetit nëpër medie është përzgjedhëse dhe jo-transparente. Institucionet publike ndajnë fonde për reklama nëpër mediet online. Banerët nëpër portale nuk tregojnë ndonjë aktivitet të veçantë të ministrive. (Seksioni A.1)

Mediat e minoriteteve financohen nga buxheti i shtetit përmes transmetuesit publik, Radiotelevizioni i Kosovës. RTK-ja përfshin programet në gjuhët Serbe, Boshnjake, Turke dhe Rome. Që nga 2013, komuniteti Serb ka kanal in e vet në RTK2. (Seksioni A.1)

Autonomia dhe pavarësia e transmetuesit publik është e garantuar me ligj por zbatohet dobët. Finansimi i drejtpërdrejtë nga buxheti i Kosovës nuk siguron pavarësi dhe autonomi të transmetuesit publik. Ligji i ri pritet të miratohet nga Kuvendi i Kosovës që parasheh kornizën financuese të përzier: 2,5 euro për amvisëri, që do të mbliidhet përmes faturave të rrymës dhe 0.4 për qind ng buxheti i shtetit për projekte të veçanta të RTK-së. Sindikata e Pavarur e RTK-së ka reaguar disa herë duke kritikuar menaxhmentin për keqmenaxhim të financave dhe punësime pa kriterë. (Seksioni A.1)

Dy gjykime janë mbajtur sa i përket pretendimeve kundër shpifjes dhe fyerjes, përfshirë një padi kundër një organizate mediale dhe tjetra padi nga një medium kundër një OJQ-je. Ekzistojnë më shumë se 50 padi të ngritura në Gjykatën Themelore të Prishtinës sa i përket shpifjes dhe fyerjes, që datojnë që nga 2010. Në disa raste, gjyqtarët janë vërejtur që marrin anë kur kanë sjellur aktgjykime dhe i kanë bërë të jenë politikisht të motivuar. Për shembull është rasti i gazetarit Vehbi Kajtazi i cili ishte fizikisht i sulmuar dhe gjykatësi në këtë rast solli aktgjykim prej katër muaj dënim me kusht për kryerësin e sulmit. (Seksioni A.2)

Kushtetuta e Kosovës dhe Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave ofrojnë garanci për pluralizmin politik në medie. Në përgjithësi, ekziston pluralizmi në mediet e Kosovës, duke përfshirë ato të transmetueshme, të shtypura dhe ato online. Gjatë zgjedhjeve, KPM-ja si organ i pavarur rregullues ka mandat për të monitoruar mediet. Gjatë periudhës jo-zgjedhore, mediat përfillin me Kodin e Mirsësjelljes së KPM-së që thekson se mediet nuk do të promovojnë interesat e një partie politike apo këndvështrimet e një partie politike. (Seksioni A.3)

Institucionet shtetërore kanë vazhduar edhe sivjet të jenë relativisht të mbyllura në komunikim me gazetarë. Autoriteteve publike, të cilave nuk u pëlqen raportimi i gazetarëve, shfrytëzojnë pozitën e tyre për t'i denigruar ata publikisht. (Seksioni A.4)

Besueshmëria e burimeve të gazetarëve është e garantuar me Ligjin për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarëve që erdhi në fuqi në vitin 2013. Gazetarët theksojnë se ndjehen të lirë të mirëmbajnë kontakte me burimet e tyre. Nuk është regjistruar asnjë rast për ndonjë urdhër nga gjykata ndaj gazetarëve që të zbulojnë burimin. (Seksioni A.5)

Gazetarët theksojnë se ka raste kur ata janë refuzuar në të drejtën për qasje në dokumente publike dhe informacion nga institucionet publike. Projektligji për Qasje në Dokumente Publike është në proces e sipër dhe parasheh një komisioner si një trup të veçantë që do të ketë fuqi mbikqyrëse. (Seksioni A.6)

Treguesit B:
Pozicioni i gazetarëve në redaksi,
etika profesionale dhe niveli i censurës

Gazetarët kanë theksuar se komuniteti vazhdon të punojë në kushte jo të mira të punës dhe me paga të ulëta. Mungesa e kontratave të punës mbetet problem për këtë komunitet duke krijuar atmosferë pasigurie në punën e tyre. Sivjet, një numër i gazetarëve dhe kameramanëve e kanë denoncuar publikisht punëdhënësin se nuk ua ka paguar për disa muaj rrogat, tatimet dhe kontributet pensionale. (Seksioni B.1)

Mediet online vazhdojnë të vërshojnë skenën mediale ndërsa numri i përgjithshëm i tyre mbetet i panjohur. Shumë sosh nuk i kanë të paraqitura informacionet se kush janë pronarët dhe kush punon në redaksitë e tyre, madje as emrat e gazetarëve nëpër artikuj. (Seksioni B.2)

Transmetuesi publik, Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) edhe këtë vit ka funksionuar me vështirësi financiare derisa projektligji ku parashihet financimi përmes parapagimit, pritet të miratohet në Kuvend. Financimi i drejtpërdrejtë nga shteti ka bërë që RTK të jetë e ndikuar nga ndërhyrjet e politikës. Sindikata e Pavarur e RTK-së ka reaguuar disa herë, duke kritikuar menaxhmentin e transmetuesit publik për keqmenaxhimin e financave dhe punësime pa konkurs. (Seksioni B.3)

Organizata jo-profitabile mediale vazhdojnë të mabjnë nivel më të lartë të pavarësisë redaktoriale edhe pse numrin i tyre është i vogël. Pasi që kanë qëndrueshmëri financiare, këto organizata mediale kaën më shumë liri për të raportuar pa pasur frikë nga ndonjë hakmarrje politike apo ekonomike. (Seksioni B.4)

Gazetarët theksojnë se redaktorët dhe pronarët kaën tendenca që të ndikojnë në punën e tyre nëse shkrimi zbulon çështje të ndjeshme duke përfshirë interesa politike apo ekonomike. Censura përmendet në takime jo-formale nga frika që mund të humbasin punën. Gazetarët po ashtu theksojnë se kolegët e tyre e dinë parakishtë se çfarë iu lejohet të raportojnë. (Seksioni B.5)

Treguesit C:
Siguria e gazetarëve

Sa i përket sigurisë së gazetarëve, trendi mbetet i njëjtë me vitin e kaluar. Në periudhën Janar- Shtator 2018, AGK ka regjistruar 13 raste. Është vërejtur në veçanti se, gazetarët hulumtues janë më të kërcënuarit, për shkak të hulumtimeve të tyre. Kërcënimet vijnë, që prej zyrtarëve të lartë shtetërorë e deri të qytetarët e rëndomtë. (Seksioni C.1)

Institucionet e drejtësisë dhe sigurisë kanë vazhduar me përforsimin e mekanizmave të sigurisë për gazetarët. Gjykata Themelore në Prishtinë ka iniciuar disa gjykime lidhur me rastet e kërcënimeve, shpifjeve dhe fyerjeve. AGK kërkon që këto institucione të jenë më efikase në trajtimin e rasteve të gazetarëve, duke kërkuar që lëndët të procedohen brenda afateve ligjore. (Seksioni C.2)

Sistemi penal dhe i drejtësisë kaën përmirësuar mekanizmat e tyre për mbrojtjen e gazetarëve dhe profesionistëve tjerë medial. Megjithatë, është e nevojshme një trajtim më efikas nga ana e policisë për rastet e kërcënimeve dhe sulmeve dhe prokuroria dhe gjykatat duhen të bëjnë më shumë për të mbyllur rastet me kohë. Perceptimi i gazetarëve mbetet se nxitësit e vërtetë të krimeve ndaj tyre nuk zbulohen kurrë. (Seksioni C.3)

A

Mbrojtja ligjore e lirive të medieve dhe gazetarëve

A.1 A siguron legjislacioni kombëtar garanci për lirinë e medieve dhe a zbatohet me efikasitet në praktikë?

Në përgjithësi, korniza ligjore për rregullimin e medieve i garanton normat themelore për mbrojtjen e lirive të medieve dhe gazetarëve. Kushtetuta e Kosovës garanton lirinë e shprehjes dhe pluralizmin e medieve duke mbrojtur “të drejtën e shprehjes, shpërndarjes dhe marrjes së informacioneve, opinionëve dhe mesazheve të tjera, pa u penguar.”³ Teksa kuadri ligjor është i përshtatshëm për lirinë e medieve, bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të gazetarëve të intervistuar, zbatimi i tij, është i dobët. Ndër arsyet për këtë, është theksuar reagimi i ngadaltë i sistemit të drejtësisë, në rastet e kërcënimeve dhe sulmeve fizike ndaj gazetarëve.

Raporti i Freedom House⁴ edhe për këtë vit rendit Kosovën tek shtetet pjesërisht të lira. Raporti thotë se Qeveria dhe interesat e biznesit ushtrojnë ndikim të panevojshëm në linjat editoriale dhe gazetarët raportojnë ngacmime dhe kërcënime të shpeshta të cilat ndikojnë në praktikimin e vetëcensurës.

Gjatë periudhës raportuese, Kuvendi i Kosovës ka pranuar disa projektligje nga Qeveria e Kosovës që afektojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi mediet, si: Projektligji për Qasje në

³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 40 (1)

⁴ Freedom House, *Liria e shtypit 2018, Qasur më 10 maj, 2018*: <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2018/kosovo>

Dokumente Publike, projektligji për Radiotelevizionin e Kosovës, projektligji për të Dhënat Personale, projektligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe projektligji për Lirinë e Asociimit në Organizata Jo-qeveritare.

Projektligji për Radiotelevizionin e Kosovës mëton të rregullojë çështjen e financimit përmes parapagimit nga qytetarët. Më këtë projektligj, që parashihet të hyjë në fuqi në vitin 2019, RTK-ja do të financohet nga qytetarët prej 2.5 euro tarifë mujore, që do të inkasohet përmes faturave të energjisë elektrike të amvisërive. Kjo praktikë ishte ndaluar së zbatuari në vitin 2009 pasi Gjykata Kushtetuese kishte vendosur masë të përkohshme. Që atëherë RTK financohet drejtpërdrejt nga buxheti i Kosovës, ndërsa kohëve të fundit i është ndarë buxheti në periudha tre mujore. Po ashtu, projektligji parasheh që Kuvendi i Kosovës, si themelues, t'ia ndajë RTK-së deri në 0,4% të Buxhetit të Kosovës për të financuar projekte për aktivitete dhe ngjarje të rëndësishme që i bjen rreth 8 milionë euro nga shuma totale e buxhetit të vendit prej rreth 2 miliardë eurove. Ky projektligj do ta zëvendësojë ligjin e vitit 2012, i cili parashihte që brenda tri vjetësh drejtuesit e RTK-së ta gjenin mënyrën afatgjate të financimit të RTK-së.

Projektligji për Qasje në Dokumente Publike është zgjeruar dhe i është afruar më shumë legjislativitetit të BE-së.⁵ Në këtë projektligj parashihet një autoritet që do të merret me institucionet publike, nëse pengojnë qasjen në dokumente publike. Komisioneri do të jetë organ i parvarur, në kuadër të Agjencisë për Informim dhe Privatësi.

Projektligji për të Dhënat Personale parasheh ndryshimin e emrit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Agjencia e Informimit dhe Privatësisë. Kjo e fundit do ta ketë kompetencën shtesë për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjit për qasje në dokumente publike. Ky projektligj do ta zëvendësojë ligjin e miratuar në vitin 2010 nga Kuvendi i Kosovës.

Në fillim të vitit 2018, Qeveria e Kosovës ka hartuar projektligjin e ri për Lirinë e Asociimit në Organizatat Jo-qeveritare, i cili është miratuar në shqyrtim të parë nga Kuvendi. Projektligji parasheh një sërë plotësime ndryshimesh nga ligji aktual që ishte miratuar në vitin 2011. Projektligji i ri për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare, në mënyrë të qartë, përcakton rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, pezullimin, shuarjen, ndalimin e veprimit dhe çregjistrimin e organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës.

Më 14 qershor 2018, projektligji për mbrojtjen e sinjalizuesve e ka marrë dritën jeshile nga Qeveria e Kosovës dhe është proceduar për votim në Kuvend. Projektligji parasheh mbrojtjen e sinjalizuesve që shpalosin informacione për çfarëdo shkelje ligjore apo dyshimi i cili kërcënon dhe cenon interesin publik në vendin e tyre të punës, qoftë në sektorin publik apo privat, pa pasur frikë nga ndëshkimi prej punëdhënësve. Ministria e Drejtësisë si hartuese e këtij projektligji, në konsultime publike me akterë tjerë relevantë të shoqërisë civile, kanë paraparë që ky projektligj t'i ketë tri lloje të sinjalizimeve: sinjalizimin e brendshëm, të jashtëm dhe atë publik.

Raportimi i informacionit tek punëdhënësi sipas dispozitave të këtij ligji konsiderohet të jetë sinjalizim i brendshëm, raportimi tek autoritetet kompetente si prokuroria dhe policia konsiderohet të jetë sinjalizim i jashtëm si dhe publikimi apo shpalosja e çfarëdo informacioni nga sinjalizuesit tek mediet është konsideruar si sinjalizim publik. Ky projektligj, përveç që parasheh mbrojtjen e sinjalizuesve dhe konfidencialitetit nga personat përgjegjës të cilët i pranojnë dhe i trajtojnë informacionet nga sinjalizuesit për çfarëdo shkelje të kryera nga punëdhënësi i tyre. Rëndësi të veçantë i kushton edhe mbrojtjes gjyqësore për sinjalizuesit, të cilëve në rast se ju cenohet e ardhmja brenda institucionit, organizatës apo kompanisë ku punojnë, kanë të drejtë në mbrojtje gjyqësore duke ushtruar padi për dëmin që i është shkaktuar në lidhje me sinjalizimin e tyre.

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka reaguar disa herë për mungesë transparence të komisionit parlamentar për medie. Më 20 qershor, AGK ka reaguar kundër mbylljes së mbledhjes ku po shqyrtohej projektligji dhe skema e financimit për Radio Televizionin e Kosovës (RTK)⁶ pa dhënë ndonjë arsytim për shkaqet e mbylljes së kësaj mbledhjeje. AGK ka rikujtuar komisionin parlamentar për medie se projektligji është i një rëndësie të veçantë për qytetarët dhe se praktikata e tilla nuk i shërbejnë transparencës së punës së Kuvendit të Kosovës dhe njëkohësisht përbën cenim të së drejtës qytetare për t'u informuar.

Në një rast tjetër, më 8 maj, AGK ka reaguar kundër komisionit të njëjtë për mos përfshirje në konsultime të asnjë pale relevante lidhur me nismën për hartimin e ligjit për medie⁷. Disa anëtarë të këtij komisioni kishin deklaruar për medie se synojnë që të "disiplinojnë" portalet dhe rregullojnë kushtet e punës për gazetarë. Prej asaj koha, ky komision nuk ka nisur ndonjë debat publik për të sqaruar në detaje se çfarë synohet të rregullohet me këtë ligj. Kosova ka një kornizë të gjerë ligjore që rre-

⁵ E qasshme në <http://ligjet.kuvendikosoves.org/LTS/DraftLawPhase?draftLawId=104&languageId=1>

⁶ I qasshëm në <http://agk-ks.org/agk-kundershton-mbylljen-e-komisionit-parlamentar-ku-po-shqyrtohej-projektligji-per-rtk-ne/>

⁷ I qasshëm në <http://agk-ks.org/komisioni-per-media-merre-iniative-per-hartimin-e-draft-ligjit-te-medieve-ne-kosovka-marre-iniative-per-hartimin-e-draft-ligjit-te-medieve-ne-kosove/>

gullon shumë fusha që ndërlidhen drejtpërdrejt me lirinë e shprehjes, mirëpo mungon vullneti politik dhe institucional, për t'i zbatuar ligjet në praktikë.

Dy autoritetet vet-rregulluese në Kosovë, Komisioni i Pavarur për Media (KPM) dhe Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) në përgjithësi perceptohen që funksionojnë në mënyrë efikase. Megjithatë, pavarësia e KPM-së po shkelur për shkak të politizimit të vazhdueshëm të përzgjedhjes së vazhdueshme politizuese të bordit drejtues që zgjedhet nga Kuvendi i Kosovës. Treguesit e qëndrueshmërisë së mediave për vitin 2018 të organizatës IREX, po ashtu është theksuar se "zgjedhja e anëtarëve të bordit është më shumë e bazuar në përkatësi politike se sa në merita profesionale."⁸

Tranzicioni nga transmetimi analog në digjital, që është përgjegjësi e KPM-së, nuk ka ndodhur as këtë vit, gjatë kësaj periudhe të raportimit. KPM lëshon licenca për transmetuesin publik dhe ata privat po ashtu edhe për të gjitha shërbimet audiovizuale. Komisioni ka të drejtë që të përtërij licencat, dhënien e të drejtës për subjektet e licencuara për të përdorur frekuencat në Spektrin e Frekuencave të Transmetimit. KPM vendos sanksione për subjektet e licencuara që shkelin rregulloret e Komisionit ose kushtet dhe kushtet e licencës.

Zyra për Çështje të Komuniteteve, përbrenda zyres së Kryeministrit, ka ndarë 500 mijë euro për një thirrje për organizatat jo-qeveritare në lidhje me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve. Krahasuar me vitin e kaluar ku disa medie në gjuhën Serbe dhe gjuhë tjera kanë fituar grante, kjo thirrje për këtë vit i është drejtuar OJQ-ve.

Autonomia dhe pavarësia e RTK-së mbrohen me ligj,⁹ i cili u miratua në vitin 2012, por që ligjvënësit e krijuan vetëm për tri vite, deri më 2015, derisa menaxhmenti të gjente një mekanizëm të ri e të pavarur të financimit. Gjendja e pasigurtë financiare e RTK-së, ka bërë që transmetuesi publik të kritikohet për anshmëri editoriale, punësime të pakontrolluara dhe nepotizëm. Megjithatë, Kuvendi i Kosovës pritet ta miratojë ligjin e ri që pritet të sigurojë qëndrueshmëri financiare për transmetuesin publik. Më 5 shkurt 2018, komisioni parlamentar për medie organizoi një debat publik duke ftuar të gjitha palët e interesuara për të diskutuar për projektligjin e RTK-së¹⁰ dhe njëra ndër kërkesat kryesore të Sindikatës së Pavarur të transmetuesit publik (SPRTK) ishte edhe mënyra e zgjedhjes së bordit në transmetuesin publik. Sindikalistët kanë kërkuar që Kuvendi i Kosovës të mos jetë organi që do t'i përzgjedh drejtpërdrejt anëtarët e bordit por një organ i pavarur dhe i përfaqësuar nga

shoqëria e gjërë që do të përzgjidhte një listë të ngushtë të kandidatëve më të mirë, për t'ia propozuar më pas deputetëve për miratim. Kjo kërkesë e sindikatës nuk u aprovua në fund nga komisioni parlamentar për medie.

Institucionet publike kanë reklamuar nëpër medie në mënyrë të përzgjedhur dhe jo-transparente. Ministrinë dhe agjencitë tjera shtetërore kanë vazhduar po ashtu këtë vit që të ndajnë para për mediet online. Banerët nëpër portale nuk paraqesin ndonjë aktivitet të institucioneve publike por thjeshtë ju drejtojnë nëpër ueb-faqe të institucioneve.

A.2 A shkakton ligji i shpifjes efekt shqetësues mes gazetarëve?

Ligji civil kundër shpifjes dhe fyerjes nuk ka dispozita të veçanta që do të krijonin efekte shqetësuese tek gazetarët e paditur për shpifje apo fyerje. Me adoptimin e këtij ligji në vitin 2012, është dekriminalizuar shpifja dhe fyerja në Kosovë, duke i larguar nenet nga Kodi Penal i Kosovës që parashikonin dënime me burg për shpifësit.

Vitin e kaluar, qeveria dështoi në nismën e saj për amendamentimin e Kodit Penal që kishte për qëllim t'i sanksiononte penalisht nga tre muaj deri në pesë vjet burgim, gazetarët, mediet dhe këdo, që do të shpifte apo fyente një trup kushtetues, përfshirë Presidentin, Kuvendin, Qeverinë dhe Gjykatën Kushtetuese.

Në fillimvit, gjykatat në Kosovë kanë nisur që t'i trajtojnë paditë për shpifje apo fyerje, duke shënuar kështu rastet e para të zbatimit të ligjit kundër shpifjes. Deri më tash janë regjistruar 59 raste, 10 janë ngritur nga zyrtarët shtetërorë madje shumica prej tyre janë figura të larta, 5 raste janë ngritur nga avokatë dhe gjyqtarë kundër gazetarëve dhe medieve, 6 raste janë ngritur nga mediumi/gazetari kundër një mediumi/gazetari tjetër.

Më 3 janar 2018, Gjykata Themelore në Pejë ka marrë vendim në favor të një gazetari i cili kishte paditur një kompani vendore për një fushatë fyese që kishte bërë ndaj tij Sipas aktgjykimit, kompania vendore detyrohet t'i paguaj kompensim gazetarit 15,000 euro për fushatën fyese të bërë ndaj tij përmes stendave afishuese në vitin 2015. Gazetari kishte shkruar për një produkt të kësaj kompanie që nuk i përfille standardet dhe kishte ngritur shqetësime publike. Kompania, në shenjë hakmarrjeje, kishte vendosur stenda afishuese me emrin e gazetarit

⁸ IREX, Media Sustainability Index, Accessed on October 10, 2018: <https://www.irex.org/sites/default/files/pdf/media-sustainability-index-europe-eurasia-2018-kosovo.pdf>

⁹ Ligji Nr 04/L-046 për Radio Televizionin e Kosovës, neni 18

¹⁰ E qasshme në <https://www.youtube.com/watch?v=IukOYFQqg4Y&feature=youtu.be>

duke e paraqitur atë bashkë me foton e një kafshe.

Më 4 qershor 2018, Gjykata Themelore e Prishtinës e ka hedhur poshtë padinë e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe ish-drejtorit të saj, Hasan Preteni për shpifje dhe fyerje kundër organizatës jo-qeveritare “Çohu”.¹¹ Gjykata vlerësoi se padia e AKK-së është e pabazë, pasi, ligji civil kundër shpifjes dhe fyerjes nuk u lejon autoriteteve publike të paraqesin kërkesë në cilësinë e personit publik, për kompensim për dëmin e shkaktuar nga shpifja ose fyerja por atë mund ta bëjnë privatisht në kapacitetin e tyre personal. Preteni kishte pretenduar se organizata “Çohu”, në një konferencë për medie ka shpifur ndaj tij si person zyrtar duke thënë se kishte mbrojtur shtatë deputetë të Kuvendit të Kosovës për mosdeklarim të pasurisë. Ai në cilësinë e drejtorit të Agjencisë kundër Korrupsionit, pretendonte se qëndrimet e organizatës “Çohu”, kanë prodhuar pasoja për personalitetin e tij, me ç’rast kishte kërkuar dëmshpërblim 100 mijë euro, si dhe pagimin e të gjitha shpenzimeve procedurale gjyqësore. Mirëpo, në vendimin e datës 10 maj 2018, gjykata përveç që e ka hedhur poshtë padinë e Pretenit, ajo e ka obliguar atë t’ia kompensoj organizatës “Çohu”, të gjitha shpenzimet e kësaj procedure kontestimore në vlerë prej 1,393.60 euro.

Sivjet, Gjykata Themelore e Prishtinës ka trajtuar edhe një rast që ka të bëjë me shpifje.¹² Kjo gjykatë e ka hedhur poshtë padinë për shpifje dhe fyerje të ushtruar nga televizioni privat, Klan Kosova ndaj organizatës “Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut” (YIHR) duke theksuar se në asnjë rast nuk është vërtetuar se ekzistojnë elemente të shpifjes dhe fyerjes.

Në maj të vitit 2010, organizata Youth Initiative for Human Rights (YIHR), kishte publikuar raportin “State of Constriction”, me gjetje për kufizimin dhe raportimin e medieve, me konkretisht për skenën mediele të viteve 2008-2009 në Kosovë. Klan Kosova, ishte paraqitur në këtë raport si medie që e “favorizonte Partinë Demokratike të Kosovës” gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2009. Pas një muaji, në qershor të vitit 2010, Klan Kosova dhe drejtori i saj, Baton Haxhiu, kishin ngritur padi për shpifje dhe fyerje ndaj organizatës “YIHR”.

Paditësi pretendonte se publikimi i kishte sjellë televizionit dëmtim të reputacionit dhe humbje materiale nga marketingu, me ç’rast kishte kërkuar dëmshpërblim prej 285 mijë eurosh. Gjykata ka vendosur se nuk ka pasur dëmtim të reputacionit, ngase ka qenë vetëm një opinion i autorit të këtij raporti dhe se sipas ligjit civil kundër shpifjes dhe fyerjes, nuk mund të ketë kufizime nga

asnjë autoritet për opinione të tilla.

Pretendimet për shkaktim të dëmit material, Gjykata Themelore e Prishtinës i ka vlerësuar si të pa bazuara duke theksuar se paditësi nuk ka mundur me asnjë provë të argumentojë se ekziston një dëm i tillë. Gjykata në Prishtinë e ka obliguar paditësin që t’ia mbuloj shpenzimet e procedurës kontestimore, të paditurës, organizatës “YIHR”, në shumë prej 1.019.20 euro.

A.3 A ka mbrojtje të mjaftueshme ligjore të pluralizmit politik në medie para dhe gjatë fushatave zgjedhore?

Kushtetuta e Kosovës ofron garanci për pluralizmin e medieve.¹³ Ligji për Komisionin e Pavarur të Medieve gjithashtu mbështet liritë dhe pluralizmin e shërbimeve mediale audio-vizuale në Kosovë.¹⁴ Mediet në Kosovë nuk janë të obliguara me ligj në raport me pluralizmin politik në periudhat jo zgjedhore, por kjo çështje është e rregulluar me kod të sjelljes për të gjitha mediet.

Në përgjithësi, ekziston pluralizmi në mediet e Kosovës, duke përfshirë mediet elektronike, të shtypura dhe online. Komisioni i Pavarur për Medie është organ vet-rregullues dhe ka në mandat edhe monitorimin e medieve gjatë fushatave zgjedhore. Kodi i Sjelljes i Komisionit të Pavarur për Medie për shërbimet audio-vizuale thotë se shërbimet medietike audio-vizuale nuk do të promovojnë interesat e një partie politike apo një këndvështrimi politik. KPM-ja licenson transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik, të cilët ofrojnë shërbime mediele audio-vizuale.

Ligji Zgjedhor¹⁵ rregullon mbulim medietik gjatë fushatës zgjedhore, dhe kërkon nga të gjitha mediet që ta respektojnë Kodin e Sjelljes për Mediet Transmetuese dhe Kodin e Sjelljes për Mediet e Shkruara, të hartuara nga Komisioni i Pavarur për Medie, në lidhje me të gjitha aspektet e mbulimit dhe reklamave të fushatës.

Sipas Komisionit të Pavarur të Medieve, në vitin 2018, Kosova ka 20 stacione televizive, 83 radio stacione, 61 ofrues të shërbimeve programore dhe 38 operatorë të shpërndarjes.¹⁶ Në Kosovë janë pesë gazeta të përditshme ndërsa numri i medieve online mbetet i panjohur, edhe pse portale të reja hapen dhe lansohen në mënyrë të rregullt.

¹¹ E qasshme në <http://agk-ks.org/hasan-preteni-humb-betejen-ligjore-organizaten-cohu/>

¹² E qasshme në <http://agk-ks.org/gjykata-refuzon-padine-klan-kosoves-ndaj-organizates-yihr/>

¹³ Kushtetuta e Kosovës, neni 42

¹⁴ Ligji Nr. 04/L-044 për komisionin e pavarur për media, neni 5

¹⁵ Ligji Nr.03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, Kapitulli VIII, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2722>

¹⁶ E qasshme në <http://www.kpm-ks.org/?faq=418&gjuha=1>

A.4 A është liria e punës dhe asociimit të gazetarëve e garantuar dhe e zbatuar në praktikë?

Gazetarët e kanë të garantuar me ligj, lirinë e punës dhe të asociimit. Në Kosovë janë dy asociacione të gazetarëve, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) dhe Asociacioni i Gazetarëve Serb në Kosovë. AGK ka numër më të madh të anëtarëve dhe në të janë të përfshirë gazetarë edhe nga komunitete tjera. Në Kosovë vazhdon të mos ketë sindikatë që përfaqëson interesat e të gjithë gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë medialë. Viteve të fundit nuk ka pasur asnjë debat në lidhje me këtë çështje. Kur gazetarët kanë pretenduar se u janë shkelur të drejtat e punës, i janë drejtuar AGK-së, e cila i ka këshilluar për hapat e mëtejme. AGK, në disa raste, ka shërbyer si ndërmjetësuese në mes të gazetarëve dhe autoriteteve të vendit, përkatësisht inspektoratit të punës. Megjithatë, transmetuesi publik ka dy sindikata: Sindikata e Pavarur e RTK-së (SPRTK) dhe Sindikata e punëtorëve të RTK-së.

Kuvendi i Kosovës është duke shqyrtuar plotësim-ndryshimet e projektligjit për lirinë e asociimit në organizatat jo-qeveritare¹⁷ dhe ndryshimet parashihen të ndodhin që në kapitullin e parë, respektivisht nga nenet që kanë të bëjnë me qëllimet, fushëveprimtarinë dhe përkufizimet. Nenet e këtij kapitulli janë më të zgjeruara dhe më të përmbushura sa i përket aspektit të së drejtës, çka garanton një fuqizim më të madh të lirisë së asociimit në Kosovë. Projektligji i ri parashih plotësim ndryshime edhe në kapitullin e dytë, ku çdo personi i garantohet e drejta për të themeluar një organizatë, trajtim i barabartë në të drejtën e asociimit ndërsa asnjë person nuk obligohet të asociohet kundër vullnetit të tij.

Projektligji i ri parashih ndryshime edhe në nenet tjera të lirisë së asociimit, të cilat do të jenë më të zgjeruara dhe në harmoni me Kushtetutën dhe ligjet e vendit dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Për themelimin e një OJQ-je, janë shtuar disa kritere shtesë ndërsa nga 7 nenet për themelimin të një OJQ-je, me projektligjin e ri parashihen të jenë gjithsej 8 nene. Një kapitull i veçantë i kushtohet edhe statutit të OJQ-së i cili është një rregullim i hollësishëm i çështjeve të organizimit, të funksionimit dhe të veprimtarisë së organizatës. Parashihen ndryshime edhe në format e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të OJQ-së, i cili parashih një normim dhe rregullim të funksionimit të shoqatës, fondacionit apo institutit. Në kuadër të këtij kapitulli janë përfshirë edhe nenet më të zgjeruara, që kanë të bëjnë me financimin, pasurinë, mjetet dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Në Kosovë nuk ekziston ndonjë obligim ligjor për licen-

cim të gazetarëve para ndonjë autoriteti para se të nisin karrierën në gazetari. Pas përfundimit të studimeve, gazetarët e rinj nisin praktikën në ndonjë medie edhe pse kjo çështje nuk është mirë e rregulluar. Praktikantët fillojnë punën e tyre, disa me pagesë e disa jo, për një kohë të paktuar dhe pak prej tyre gjejnë vende të punës, si rrjedhojë e praktikës.

Më 3 maj 2018, në Ditën Botërore të Lirisë së Shtypit, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës organizoi një aksion protestues në qendër të qytetit me moton “Mosndëshkimi vret lirinë e shprehjes”. Në këtë protestë u kërkuva efikasitet më i madh nga institucionet e sigurisë dhe drejtësisë për trajtimin e rasteve të sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve.

Edhe gjatë vitit 2018, është vërejtur tendenca e zyrtarëve shtetërorë që ta ndërpresin komunikimin me gazetarë për shkak të shkrimeve kritike ndaj punës së tyre. Më 19 mars 2018, AGK ka reaguar ndaj vendimit të drejtorit të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA) për ndërprerje të komunikimit të agjencisë me gazetaren Ardiana Thaçi Mehmeti e cila këtë vendim e kishte marr vesh pasi i ishte refuzuar qasja në dokumente publike. Vendimi ishte rrjedhojë e disa shkrimeve hulumtuuese të gazetareve për disa supozime të keqpërdorimeve të kryera në këtë institucion. AGK ka reaguar edhe në një rast ndaj drejtorit të agjencisë, i cili kishte lincuar gazetaren duke e etiketuar, si “dezinformatore” dhe gazetarë që punon për “grupe të interesit” ndërsa këtë lincim e kishte publikuar në ekranin e vendosur në hollin kryesor të këtij institucioni dhe në uebfaqen e agjencisë. Pas reagimit dhe letrave shqetësuese të AGK-së, lajmi është larguar nga ekrani dhe ueb-faqja.

Këshilli i Medieve të Shkruara të Kosovës (KMSHK) u themelua në vitin 2005 si mekanizëm vetërregullues i formuar nga përfaqësuesit e shtypit dhe misioni i tij mbështetet në respektimin e Kodit të Medieve të Shkruara të Kosovës.

Gjatë vitit 2017, KMSHK ka proceduar me 67 ankesa nga palët e treta për shkrimet në gazeta dhe medie online. Nga ky numër, në 50 raste janë gjetur shkelje të kodit të etikës, 29 ishin kundër së përditshmes “Kosova Sot” dhe 13 të tjera kundër portalit “Gazeta Express”.¹⁸

Këshilli tani i ka 27 anëtarë të rregullt, nga gazetaret, portalet dhe agjencitë e lajmeve dhe tre anëtarë të pavarur: kryetarin dhe dy nënkryetarët. Bordi përbëhet nga përfaqësuesit e gazetave, portaleve dhe të agjencive të lajmeve. Një nga kriteret për anëtarësim në KMSHK është që mediet duhet të paraqesin të dhënat e pronësisë. Deri më sot, këshilli ka krijuar reputacion në trajtimin e ankesave nga individë apo organizata edhe pse mund të bëjë më shumë për ndërgjegjësimin e palëve të dëmtuara, për të kërkuar zgjidhje lidhur me shkeljet që u bëhen si pasojë e shkrimeve joprofesionale.

¹⁷ E qasshme në <http://ligjet.kuvendikosoves.org/LTS/DraftLawPhase?draftLawId=65&languageId=1>

¹⁸ E qasshme në <http://presscouncil-ks.org/vendimet/>

A.5 Cili është niveli i mbrojtjes ligjore të burimeve të gazetarëve?

Burimi i gazetarëve mbrohet me ligjin e miratuar nga Kuvendi i Kosovës në gusht 2013 dhe konsiderohet hap i rëndësishëm për punën e gazetarëve.¹⁹ Gjatë periudhës raportuese, nuk është shënuar ndonjë rast kur gazetari i është kërkuar nga gjykata që ta zbulojë burimin e informacionit. Ligji për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë përmban vetëm dhjetë nene dhe zbatohet për gazetaret dhe profesionistët e tjerë të medieve që janë të angazhuar për mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit nëpërmjet medieve. Sipas ligjit, gazetaret dhe profesionistët e medieve kanë të drejtë të heshtin në lidhje me burimet e tyre të informacionit. Gazetarët detyrohen t'i zbulojnë burimet e informacionit vetëm me urdhër të gjykatës, kur është e nevojshme për të parandaluar kërcënim serioz, që do të çonte në vdekjen e një apo më shumë personave.

Ligji ndalon bastisjen e ndërtesave të kompanive mediale dhe pronave të tjera, të tilla si makina apo shtëpi të gazetarëve, nëse merret ndonjë masë e hetimit që ka për qëllim ta identifikojë burimin e informacionit. Ky është një zhvillim i rëndësishëm, sepse fillimisht çështja e burimeve adresohet përmes Kodit Penal, por, pas disa protestave, u eliminuan kufizimet e pajustificueshme dhe të dëmshme, sa i përket burimeve të gazetarëve.

Në raportin e vitit 2016, shumica e gazetarëve të intervistuar përmes anketës janë përgjigjur se ndihen të lirë të mbajnë kontakte me burimet e informacionit, gjatë raportimit mbi çështjet e interesit publik. Gazetarët e anketuar (44,4%) thanë se është rritur ndërveprimi me burime, identiteti profesional i të cilëve duhet të respektohet. (23 të anketuar nga 50 nuk kishin të drejtë të përgjigjen në këtë pyetje, sepse kanë më pak se pesë vjet përvojë pune në gazetari).²⁰

A.6 Cili është niveli i mbrojtjes së të drejtës për qasje në informata?

Gazetarët e intervistuar për këtë raport, kanë theksuar se përballen me refuzime të kërkesave për qasje në dokumente publike dhe në informata nga institucionet publike. Ata theksojnë se kur bëjnë hulumtime për ndonjë çështje serioze, institucionet mbyllën në raport me gazetaret.

Projektligji i amendamentuar për qasje në dokumente publike është miratuar nga Kuvendi në leximin e parë²¹. Ky projektligj parasheh krijimin e një komisioneri që do të jetë organ i pavarur me kompetenca mbikëqyrëse rreth zbatimit të ligjit. Komisioneri do të emërohet nga Kuvendi i Kosovës dhe do të veprojë në kuadër të Agjencisë për Informim e Privatësi, e cila aktualisht funksionon me emërtimin Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave. Komisioneri është përgjegjës për ndërmarrjen dhe shqiptimin e masave të parashikuara me këtë ligj. Në rast se një kërkesë për qasje në dokumente publike është refuzuar në tërësi apo pjesërisht nga ndonjë institucion publik, kërkuesi mund t'i drejtohet me ankesë komisionerit brenda 15 ditëve prej pranimit të vendimit për refuzim ose vendimit për aprovim të pjesshëm të kërkesës për qasje. Vendimi i komisionerit është përfundimtar në procedurën administrative ndërsa mund të kundërshtohet vetëm përmes padisë në gjykatën kompetente për çështje administrative. Projektligji parasheh edhe gjoba, prej tre mijë deri në dhjetë mijë euro, për institucionet publike që pamundësojnë, pengojnë apo kufizojnë të drejtën për qasje në dokumente publike. Me gjobë prej 1.000 deri në 3.000 euro ndëshkohet për kundërvajtje institucioni publik, i cili lejon dëmtimin, shkatërrimin, fshehjen ose në ndonjë mënyrë ose formë tjetër e bënë të paqartë dokumentin publik. Gjoba janë paraparë edhe për zyrtarët përgjegjës të institucioneve publike që mund të ndëshkohen prej 500 deri në 1.000 euro. Ndërsa, institucioni publik i cili nuk përgjigjet fare në kërkesën për qasje në dokumente publike, mund të gjobetet prej 1.000 deri në 3.000 euro.

Projektligji për qasje në dokumente publike detyron institucionet publike që brenda 7 ditëve prej pranimit të një kërkesë për qasje në dokumente publike, të nxjerrin vendim për lejimin, refuzimin apo lejimin e pjesërisht të kërkesës. Institucioni publik mund ta vazhdojë afatin kohor edhe për 15 ditë shtesë nëse informata apo dokumenti duhet të kërkohet brenda një numri të madh të dokumenteve apo jashtë institucionit publik.

Në përgjithësi, takimet e kryesisë së Kuvendit të Kosovës dhe takimet e komiseve parlamentare ishin të hapura për publikun dhe për gazetaret, ashtu sikurse seancat gjyqësore. AGK ka reaguar në dy raste kur sigurimi i Kuvendit të Kosovës ka nxjerr me dhunë jashtë ndërtesës dy gazetare, në dy raste të veçanta, me arsyetimin se ata nuk ishin të akredituar përdërsa vetë Kuvendi, nuk kishte arritur që t'i akreditonte. AGK ka dërguar letra shqetësuese tek kryetari i Kuvendit dhe drejtori i Policisë së Kosovës duke kërkuar që sigurimi i Kuvendit, të jetë më i kujdesshëm në raport me gazetaret.

¹⁹ Ligji Nr. 04/L-137 për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë

²⁰ Platforma regionale e Ballkanit Perëndimor për Avokim të Lirisë së Mediave dhe Sigurisë së Gazetarëve, Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve 2016, f.27. Qasur më 7 qershor 2018: <http://safejournalists.net/wp-content/uploads/2016/12/Raport-i-plot%C3%AB.pdf>

²¹ E qasshme në <http://ligjet.kuvendikosoves.org/LTS/DraftLawPhase?draftLawId=104&languageId=1>

B

Pozicioni i gazetarëve në redaksi, etika profesionale dhe niveli i censurës

B.1 A abuzohet me pozitën ekonomike të gazetarëve për ta kufizuar lirinë e tyre?

Gjendja e rëndë ekonomike në Kosovë ka ndikuar edhe në industrinë mediale në vend, duke krijuar paqëndrueshmëri financiare. Rrjedhimisht gazetarët vazhdojnë të punojnë në kushte të vështira ekonomike dhe shoqërore. Në muajt e fundit është vërejtur largimi i gazetarëve dhe fotoreporterëve nga mediet dhe tendenca e punësimit të tyre nëpër institucione publike. Interesim i madh i gazetarëve është që të punësohen në Radiotelevizionin e Kosovës për shkak të një page më të sigurtë. Gazetarët po i braktisin mediet private për shkak të mospagesës apo rrogave të ulëta. Gazetarët e intervistuar kanë thënë se ky komunitet, vazhdon të punojë në kushte jo të favorshme për shkak të mungesës së kontratave të punës, pagave të ulëta, ose pagesave të vonuara.

“Janë të pakta medime që lidhin kontrata me gazetarët që është një prej kushteve kryesore që do të garantonte punën e gazetarit. Po ashtu, është edhe mostransparenca në pagesa, dhe dua të them se gazetarët ende paguhen në dorë ose me zarfë.”²²

Më 23 korrik 2018, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, i ka bërë thirrje institucioneve të vendit, respektivisht Inspektoratit të Punës dhe Prokurorisë së Shtetit që t'i hetojnë denoncimet publike të gazetarëve, kameramanëve dhe producentëve se punëdhënësi

22 Shkumbin Kajtazi, gazetar, intervista e mbajtur më 22 maj 2018

i tyre pronar i “Tribuna Media Group”, nuk ua kishte paguar rrogat me muaj të tërë, por as tatimet dhe kontributet pensionale.

Një grup i këtyre gazetarëve pasi kishin dhënë intervista të detajuara për një portal janë keqtrajtuar dhe u janë shkëlur të drejtat e punës nga pronarët e mediumit.²³

AGK edhe më herët, lidhur me akuzat e njëjta të punëtorëve të këtij mediumi, i është drejtuar Inspektoratit të Punës, ndërsa më pas lënda është proceduar për shqyrtim edhe në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Aktualisht rasti gjendet tek përmbartuesi privat ndërsa AGK po e monitoron procesin.

Gazetarët nuk kanë mbrojtje të duhur sociale. Ata nuk kanë sigurim shëndetësor dhe nuk paguhen për pushim mjekësor. Gazetarët theksojnë se ligji i punës në përgjithësi nuk respektohet nga punëdhënësit, e sidomos kur janë në pyetje pushimet vjetore dhe javore. Në Kosovë ekziston një numër i vogël i medieve që i përmbyshin këto obligime ligjore.

“Pagat dhe kontratat nuk na dallojnë nga bizneset tjera. Nivelin e papunësisë në Kosovë e shfrytëzojnë edhe mediet, kushtimisht po them, për shkak se momenti kur ke kërkesa të mëdhaja për punësim, ti e ke lluksin që mos me i rrit pagat apo duke mos iu përshtatur rritjes së inflacionit.”²⁴

Sjellim disa të dhëna nga anketa e realizuar me gazetarë dhe redaktorë në vitin 2016. Pothuajse gjysma e gazetarëve patën deklaruar se pagat e tyre mujore variojnë prej 200 deri në 500 euro. Ndërsa pagat e redaktorëve sillen nga 600 deri në 900 euro (përfshirë këtu edhe pagat në transmetuesin publik).²⁵

B.2 Cili është niveli i pavarësisë editoriale nga pronarët e medieve dhe strukturat udhëheqëse?

Ekziston një perceptim i gjerë se niveli i pavarësisë editoriale është i ulët, pasi reklamat janë burimi i vetëm i të hyrave nëpër medie private dhe herë pas here menaxherët apo pronarët e medieve ndikojnë nëpër

redaksi që të mos publikohen shkrimet që kritikojnë kompanitë që janë reklamues të mëdhenj. Mediet më të mëdha kanë struktura të ndara organizative, që i mbajnë redaksitë të ndara nga menaxhmenti dhe departamenti i marketingut, por, problemi qëndron tek mediet online të cilat nuk kanë shumë punëtorë dhe zyret e tyre janë, kryesisht hapësira banesore të siguruara me qira, të cilat nuk kanë hapësirë të mjaftueshme për punë.

Mediet e shtypura dhe ato online shfrytëzojnë kodin e përgjithshëm të etikës të miratuar nga Këshilli i Medieve të Shkruara të Kosovës. Ndërsa, transmetuesit privatë veprojnë në pajtim me kodin e përgjithshëm të etikës së Komisionit të Pavarur për Medie.

Mediet online vazhdojnë të mos publikojnë emrat e gazetarëve, shumë prej tyre nuk i paraqesin impressum-et e tyre. Kjo po paraqet problem për palët e treta pasi që nuk janë në gjendje të identifikojnë gazetarin, redaktorin apo pronarin e portalit kur ata duan të bëjnë ankesë për përmbajtjen e ndonjë artikulli. Po ashtu, e drejta e autorit vazhdon të mos respektohet ndërsa shumë medie online ri-publikojnë lajme pa kërkuar leje paraprake për të bërë një gjë të tillë.

B.3 Cili është niveli i pavarësisë editoriale të gazetarëve në RTK?

Radiotelevizioni i Kosovës është i vetmi transmetues publik në vend dhe ka katër kanale, një portal dhe dy radio stacione. RTK vazhdon të financohet nga shteti. Kuvendi i Kosovës është duke amandamentuar projektligjin ku parashihet zgjidhja e qëndrueshme e financimit. Të gjithë gazetarët e intervistuar theksuan se RTK-ja ushtron pavarësi të ulët editoriale si pasojë e financimit të drejtpërdrejtë nga shteti. “Problemet në RTK janë akumuluar që një kohë të gjatë. Financimi i saj nga buxheti i shtetit e ka bërë që të jetë krejt i varur. Politizimi është i skajshëm.”²⁶

Radiotelevizioni i Kosovës ka kodin e vet të sjelljes që quhet “Standardet profesionale dhe parimet etike në programet e RTK-së” dhe konsiderohen si standarde të avancuara. Por, transmetuesi publik vazhdon të kritikohet për anshmëri për shkak të ndërhyrjes së drejtpërdrejtë

23 Insajderi, “Tribuna e mashtrimit – televizioni që u ka mbetur mijëra euro borxh dhjetëra punëtorëve”, 22 korrik 2018, qasur më 10 gusht 2018, <http://www.insajderi.com/hulumtime/tribuna-e-mashtrimit-televizioni-qe-u-kambetur-mijera-euro-borxh-dhjetera-punetoreve/>

24 Visar Prebreza, gazetar, intervista e mbajtur më 24 maj 2018

25 Platforma regjionale e Ballkanit Perëndimor për avokim të lirisë mediave dhe sigurisë së gazetarëve, Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve, f.32, qasur më 15 gusht 2018: <http://safejournalists.net/wp-content/uploads/2016/12/Raport-i-plot-i-C3%AB.pdf>

26 Albert Ahmeti, gazetar, intervista e mbajtur më 23 maj 2018.

politike në pavarësinë editoriale, madje ekziston një bindje e hapur tek gazetarët e intervistuar se këto standarde nuk përfillen.

Në anën tjetër, menaxhmenti i Radiotelevizionit të Kosovës, është kritikuar shumë herë, gjatë raportimit para komisionit parlamentar për medie²⁷ për shkak të punësimeve të vazhdueshme pa kriteret dhe mbipunësimeve, përkundër telasheve financiare, sidomos në vitet e fundit. Nga 725 punëtorë të rregullt sa ishin deri në dhjetor 2016,²⁸ ky numër është rritur në 769 punëtorë të raportuar në fund të vitit 2017.²⁹ Këto punësime janë përcjellur me kritika të shumta duke vënë theksin në nepotizëm.

Sindikata e Pavarur e RTK-së (SPRTK) ka ngritur disa herë shqetësimet e saj, duke kritikuar menaxhmentin për keqmenaxhim dhe nepotizmin. Së fundmi, kjo sindikatë ka reaguar për punësime, siç thonë ata, të pakontrolluara në transmetuesin publik, madje në disa raste edhe pa konkurs. Sindikata ka theksuar se menaxhmenti nuk është duke përfillur rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm për mospunësime, për shkak të gjendjes së vështirë financiare.

B.4 Cili është niveli i pavarësisë editoriale të gazetarëve në sektorin jo-fitimprurës?

Ekziston një numër i vogël i medieve jo-fitimprurëse në Kosovë. Niveli i pavarësisë editoriale në sektorin jo-fitimprurës është shumë më i lartë krahasuar me sektorët e tjerë. Mediet në këtë sektor, vazhdojnë të jenë financiarisht më të qëndrueshme për shkak se funksionojnë kryesisht nga donacionet, si: Rrjeti Ballkanik për Gazetari Huluntuose (BIRN), Organizata Çohu dhe Instituti i Kosovës për Drejtësi, që janë të përqendruar në gazetarinë huluntuose.

Këto medie mbulojnë kryesisht çështjet që ndërlidhen me sistemin e drejtësisë, shpenzimet publike dhe korrupsionin. Pasi kanë qëndrueshmëri financiare, këto medie, janë më të lira të raportojnë pa frikë nga ndonjë hakmarrje politike apo ekonomike. Mediet jo-fitimprurëse veprojnë në përputhje me kodin e përgjithshëm të etikës për medie të shkruara dhe vizuale, ndërsa disa prej tyre kanë kode të brendshme të sjelljes.

B.5 Sa liri kanë gazetarët në procesin e prodhimit të lajmeve?

Në përgjithësi gazetarët kanë liri të mjaftueshme për të zgjedhur lajmet e ditës, nëse nuk i përcaktohet ndryshe nga redaktori. Këta të fundit, bëjnë përzgjedhjen se cili kënd i lajmit duhet të theksohet. Gazetarët e intervistuar theksojnë trendin e mbulimit të drejtpërdrejtë të konferencave, e sidomos atyre nga mediet online, përmes gazetarëve të cilët incizojnë me telefona të mençur dhe transmetojnë në llogarinë e tyre në Facebook dhe në portal.

Sipas anketës së vitit të kaluar, gazetarët u pyetën për shumë faktorë që mund të ndikojnë në punën e tyre të përditshme. Ata deklaruan se redaktorët kanë më shumë ndikim (tepër, shumë apo deri diku me ndikim 84%) në punën e tyre, ndërsa menaxherët (44%) dhe pronarët (42%) kanë më pak ndikim. Në anën tjetër, politikanët në përgjithësi (14%) dhe zyrtarët e qeverisë (14%) kanë shumë më pak ndikim në punën e përditshme të gazetarëve, e në fund individët që punojnë në mjedisin e tyre të përditshëm.

Mbi censurën, gazetarët (30%) u shprehën se ka ndikim në punën e tyre, ndërsa 28 për qind e gazetarëve thanë se censura nuk ka ndikim.

27 *Ekonomia Online*, "RTK-ja, që ankohet për mungesë të buxhetit, rrit numrin e punëtorëve", *Ekonomia Online*, 19 korrik 2018. Qasur më 15 gusht 2018: <http://www.ekonomiaonline.com/nacionale/rtk-ja-qe-ankohet-per-mungese-te-buxhetit-rrit-numrin-e-punetoreve/>

28 *Radiotelevizioni i Kosovës, Raporti i Auditorit të Pavarur 2016*, Prishtinë, f.11, qasur më 16 gusht 2018: http://www.rtklive.com/pages/files/Raporti_Auditorit_2016_al.pdf

29 *Radiotelevizioni i Kosovës, Raporti i Auditorit të Pavarur 2017*, Prishtinë, f.10, qasur më 16 gusht 2018: http://www.rtklive.com/sq/pages/files/pf_dhe_rap_2017_1.pdf



C.1 Statistikat e Sigurisë dhe Pandëshkueshmërisë

Prej 1 janarit deri më 20 shtator 2018, AGK-ja ka regjistruar 13 raste të kërcënimeve me jetë, kërcënimeve verbale, sulmeve fizike dhe dëmtimeve në pronë.

Më poshtë është tabela me rastet kundër gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë medi-alë, sipas kategorizimit të ri të bërë nga Platforma Rajonale.

Kërcënime kundër jetës dhe lëndime trupore të gazetarëve	Kërcënime të tjera ndaj gazetarëve	Sulmet aktuale ndaj gazetarëve	Vrasjet e gazetarëve	Kërcënimet kundër medieve dhe organizatave mediale	Sulmet ndaj medieve dhe organizatave mediale	Total
4	5	2		1	1	13

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka reaguar ndaj dy rasteve të ndara kur gazetarët, Taulant Osmani dhe Lumturije Blakaj ishin nxjerrë me forcë nga ndërtesa e Kuvendit të Kosovës nga anëtarët e sigurimit. AGK ka vërejtur se gjatë kohës së tensioneve politike në vend, gazetarët bëhen cak dhe puna e tyre pengohet. AGK ka dërguar letra shqetësuese te Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli dhe tek Drejtori i atershëm

i Policisë së Kosovës, Shpend Maxhuni duke kërkuar liri për punën e gazetarëve në Kuvend.³⁰

Dy gazetarë janë sulmuar fizikisht gjersa ata mbulonin tregime në terren. Foto-reporteri, Blerim Uka ishte sulmuar nga një grup i të rinjve në pjesën veriore të Mitrovicës. Uka ishte goditur me shkopinjë gjersa pajisjet e tij ishin dëmtuar. Valon Rashiti ishte duke raportuar për një rast ku dy persona ishin lënduar. Rashiti kishte shkuar në spitalin e Prishtinës dhe ai ishte sulmuar atje nga një anëtar i familjes të njëritë victim, i cili e kishte goditur në kokë.

Gazetari Shkumbin Kajtazi ishte kërcënuar dhe sharë nga kryetari i Mitrovicës, Agim Bahtiri. Ky i fundit e kishte thirrur atë në telefon në lidhje me një artikull. Policia e Kosovës ka lëshuar një kallëzim penal ndaj kryetarit Bahtiri.

Ueb-faqja e programit televiziv “Slobodno Srpski” ishte sulmuar katër herë nga hakerët gjatë një periudhe të shkurtër kohore. Autori i programit, Budimir Niciç dyshon se sulmet kanë ndodhur për shkak të prezencës së një mysafiri i cili kishte folur për situatën politike në pjesën veriore të Kosovës.

Ekipi i “Gazeta Insajderi” kishte pranuar kërcënime me vdekje përmes telefonit nga një pronar lokal i një kompanie pas publikimit të një hulumtimi në lidhje me përfshirjen e kompanisë në të ashtuquajturin ‘skandali i mishit’.

Më 7 qershor 2018, Federata Evropiane e Gazetarëve miratoi një rezolutë për hetimin e vrasjeve dhe rrëmbimeve të 14 gazetarëve në periudhën 1998-2005. Rezoluta është propozuar nga asociacionet e gazetarëve në Kosovë dhe Serbi dhe një nga pikat është kërkimi i bashkëpunimit midis Prishtinës dhe Beogradit për këto raste. Rezoluta kërkon zgjatjen e mandatit të Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe Prokurorisë Speciale, për t’i përfshirë rastet e gazetarëve të vrarë dhe të zhdukur.

Në vazhdim është lista e gazetarëve të vrarë e të zhdukur në Kosovë:

Enver Maloku, themelues i Qendrës Informative të Kosovës, i vrarë më 11 janar 1999 afër banesës së tij në Prishtinë.

Shefki Popova, gazetar shumëvjeçar në gazetën “Rilindja”, i vrarë më 10 shtator 2000 në hyrje të banesës së tij në Vushtrri.

Xhemajl Mustafa, i vrarë më 23 nëntor 2000 në hyrje të banesës së tij në Prishtinë.

Bekim Kastrati, gazetar në “Bota Sot”, i vrarë më 19 tetor 2001 në pritje afër fshatit Llaushë, Skenderaj.

Bardhyl Ajeti, gazetar i së përditshmes “Bota Sot”, i vrarë më 3 qershor 2005 në pritje në afërsi të fshatit Bresalç, Gjilan.

Ranko Perenic dhe Djuro Slavuj, gazetarë në Radio Prishtinë, të rrëmbyer dhe zhdukur më 21 gusht 1998 derisa ishin duke shkuar për në fshatin Zoqishtë të Rahovecit për të bërë një lajm në lidhje me kthimin e një murgu të rrëmbyer.

Ljubomir Knezevic, gazetar i “Jedinstvo” dhe korrespondent i gazetës beogradase “Politika”, i rrëmbyer dhe i zhdukur më 6 maj 1999 në afërsi të Vushtrrisë.

Milo Buljevic, gazetar i RTV Prishtinës është rrëmbyer më 25 qershor 1999, jo larg qendrës së refugjatëve ku ka jetuar. Mbetet person i pagjetur.

Krist Gegaj, punëtor në Radiotelevizionin e Prishtinës, i vrarë më 12 shtator 1999.

Momir Stokuca, fotoreporter në gazetën e përditshme “Politika”, i vrarë më 21 shtator 1999 në shtëpinë e tij në Prishtinë.

Afrim Maliqi, gazetar i së përditshmeve “Rilindja” dhe më pas “Bujku”, i vrarë më 2 dhjetor 1998 në Prishtinë.

Marjan Melonasi, gazetar në redaksinë e Radio Kosovës në gjuhën serbe, i rrëmbyer më 9 shtator 2000, aktualisht i zhdukur.

Aleksandar Simovic, i zhdukur më 21 gusht 1999. Mbetjet mortore të tij, janë gjetur në fshatin Obri afër Drenasit.

C.2 A mbajnë përgjegjësi institucionet shtetërore dhe akterët politikë për mbrojtjen e gazetarëve?

Institucionet shtetërore të drejtësisë dhe sigurisë kanë vazhduar sivjet t’i përmirësojnë mekanizmat për mbrojtjen e gazetarëve. Kryetarja e Gjykatës Themelore të Prishtinës e ka caktuar një koordinator për rastet e gazetarëve. Koordinatori njëherësh nënkryetar i gjykatës, në takimin me përfaqësuesit e AGK-së, ka vendosur që të krijoj një bazë të dhënash me të gjitha rastet e gazetarëve në lëndët penale dhe civile.

Policia e Kosovës ka vendosur që rastet e sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve t’i trajtojë Departamenti i Krimeve të Rënda. Policia inkurajohet që të zgjerojë he-

³⁰ Për rastet e tjera të regjistruara nga AGK, klikoni në linkun në vijim: <http://safejournalists.net/ks/homepage/>

timet e veta për disa raste të sulmeve fizike ndaj gazetarëve për të hetuar se kush janë përgjegjësitet e tjerë të përfshirë në sulm.

Në anën tjetër, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka emëruar prokurorët që do të jenë përgjegjës për komunikim me medie. Ky vendim është marrë për të përmirësuar komunikimin me gazetarë si pjesë e strategjisë së re të marrëdhënieve të prokurorisë me medie.

C.3 A i trajton në mënyrë të efektshme sistemi i drejtësisë penale dhe civile kërcënimet dhe aktet e dhunës kundër gazetarëve?

Siç është cekur më lartë, sistemi i drejtësisë ka shënuar disa hapa pozitiv në krijimin e një mekanizmi që mund t'i bëjë gjykatat më të efektshme në lidhje me kërcënimet dhe aktet e dhunës kundër gazetarëve, siç është emërimi i një koordinatori dhe krijimi i një baze të dhënash nga Gjykata Themelore e Prishtinës. Por, sistemi i drejtësisë duhet të tregohet më efikas në trajtimin e kërcënimeve dhe akteve të dhunës kundër gazetarëve, duke i proceduar rastet e gazetarëve brenda afateve ligjore. Procedimi dhe zgjidhja e këtyre rasteve me kohë nga gjyqësori, ndikon drejtpërdrejt në krijimin e një ambienti me të sigurt në punën e gazetarëve dhe në rritjen e profesionalizimit të mediet. Po ashtu, këto institucione janë kritikuar për politikën e butë të dënimeve që ndaj rasteve të gazetarëve të sulmuar e kërcënuar dhe ky debat ka nisur të zë vend më shpesh në takimet ndërmjet gazetarëve dhe autoriteteve të drejtësisë dhe sigurisë.

Tashmë gjykata ka identifikuar shumë raste që me vite të tëra presin të procedohen nga gjyqtarët. Një rast i lëndës civile ka filluar të trajtohet nga Gjykata Themelore e Prishtinës dhe ka të bëjë me një gazetar, që ka bërë padi ndaj punëdhënësit duke supozuar se është degraduar padrejtësisht për disa pozita. Seanca e parë është mbajtur në muajin shtator.

Gjatë kësaj periudhe të raportimit, janë mbajtur pesë gjykime, përfshirë një rast të sulmit fizik dhe katër raste të padive për shpifje. Më 15 gusht 2018, Gjykata Themelore në Mitrovicë, dega në Vushtrri ka shpallur aktgjykim dënues ndaj dy personave të cilët kishin kërcënuar një gazetar në vitin 2016. Të pandehurit akuzoheshin për veprat penale “kanosje”, “lëndimi i lehtë trupor” dhe “asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë”. Njëri nga të dënuarit, ish-asamblist në Komunën e Mitrovicës, u dënua me pesë muaj ndërsa personi tjetër me katër muaj burgim. Gazetari ishte sulmuar dhe rrahur me shufra hekuri, për shkak të një shkrimi.

Më 3 janar 2018, Gjykata Themelore në Pejë sjell aktgjykim kundër një kompanie vendore për shkak të fushatës linçuese ndaj një gazetari. Në mars të vitit 2015, kompania kishte shpërndarë në qytetin e Pejës stenda afishuese fyese me një foto të gomarit, duke aluduar në gazetarin. Kompania është gjetur fajtores dhe është dënuar me 15 mijë euro.

Më 11 janar 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë vendosi në favor të një konsorciumi të OJQ'Ve të cilët kërkuan qasje në kontratën ndërmjet qeverisë në Prishtinë dhe KEDS-it, kompani që udhëheq distribucionin e energjisë elektrike që nga qershori 2012. Padija ishte bërë më 3 qershor 2013. Verdicti i Gjykatës Themelore në Prishtinë i datës 9 janar 2018 thotë se Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Korporata Energjetike e Kosovës janë gjetur fajtor duke shkelur Kushtetutën e vendit dhe ligjin në qasje në dokumente publike. Gjyqtari i rastit ka theksuar se qytetarët kanë të drejtë në qasje të dokumenteve publike, madje kur edhe ato janë në fazën e draftimit.

Më 26 tetor 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë ka dënuar me gjobë prej 500 euro ish-zyrtarin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, për shkak të një kërcënimi të bërë ndaj një gazetari në vitin 2014.

Më 27 shtator 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë ka dënuar me gjobë prej 300 eurosh një person, pasi kishte kërcënuar me jetë dy gazetarë, për shkak të një lajmi ku përfshihej vëllai i tij.

Më 14 nëntor 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë ka dënuar me katër muaj burg me kusht, një person i cili kishte sulmuar fizikisht gazetarin në qendër të Prishtinës, pas një artikulli hulumtues.

Komuniteti i gazetarëve ka kritikuar politikën e dënimeve të gjykatave në rastet e gazetarëve duke theksuar se gjyqtarët po vendosin masa ndëshkuese minimale të parapara me ligj. Njëri prej gazetarëve të intervistuar ka theksuar se dënimet e lehta stimulojnë dhe inkurajojnë sulmet ndaj gazetarëve.

“Ke skandaloz gjykimi në rastin e sulmit fizik ndaj Vehbiut. Ai dënim që është dhënë ka qenë skandaloz. Shumë lehtë për dikënd që ta rreh në pikë të ditës, denigron në publik, frikëson dhe në fund nuk dënohesh. Ai realisht nuk është dënuar,” tha gazetari Besnik Krasniqi³¹.

Prokuroria e Shtetit ka njoftuar se ka ngritur katër akta-kuza për rastet e vitit 2017. Prej tyre, vetëm tri raste të kërcënimeve janë raportuar nga gazetarët në Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës dhe pritet të procedohen nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

31 Besnik Krasniqi, gazetar, intervista e mbajtur më 29 maj 2018.

Shtojca

Lista e personave të intervistuar

Emri	Pozita, Organizata	Data e intervistës
Shkumbin Kajtazi	Gazetar në portalin gazeta Metro	22 maj 2018
Eraldin Fazliu	Gazetar në Kosovo 2.0	22 maj 2018
Albert Ahmeti	Gazetar në Gazeta Zëri	23 maj 2018
Visar Prebreza	Gazetar në BIRN	24 maj 2018
Ardiana Thaçi-Mehmeti	Gazetare në KTV	24 maj 2018
Besnik Krasniqi	Gazetar në Koha Ditore	29 maj 2018
Mentor Gjergjaj	Gazetar në Gazeta Express	30 maj 2018

Referenca dhe burime

Libra, kapituj, artikuj:

Platforma regjionale e Ballkanit Perëndimor për avokim të lirisë medieve dhe sigurisë së gazetarëve, Treguesit e nivelit të lirisë së medieve dhe sigurisë së gazetarëve 2016, qasur më 15 gusht 2018: <http://www.safejournalists.net/ep-content/uploads/2016/12/Raporti-i-plot%C3%AB.pdf>

Freedom House, Liria e shtypit 2018, Qasur më 10 maj, 2018: <http://www.freedomhouse.org/report/freedom-world/2018/kosovo>

Radiotelevizioni i Kosovës, Raporti i Auditorit të Pavarur 2016, Prishtinë, f.11, qasur më 16 gusht 2018: http://www.rtklive.com/pages/files/Raporti_Auditorit_2016_al.pdf

Dokumentet ligjore, politika:

Kushtetuta e Kosovës

Projektligji për qasje në dokumente publike

Projektligji për lirinë e asociimit në OJQ

Projektligji për Radio Televizionin e Kosovës

Ligji Nr 04/L-046 për Radio Televizionin e Kosovës

Ligji Nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur për Medie

Ligji Nr.03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës

Ligji Nr. 04/L-137 për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë

Projektligji për të dhënat personale

Artikuj të medieve:

I qasshëm në <http://www.agk-ks.org/agk-kundershton-mbylljen-e-komisionit-parlamentar-ku-po-shqyrtohej-projektligji-per-rtk-ne/>

I qasshëm në <http://www.agk-ks.org/komisioni-per-medie-merre-iniative-per-hartimin-e-draft-ligjit-te-medieve-ne-kosovka-marre-iniative-per-hartimin-e-draft-ligjit-te-medieve-ne-kosove/>

E qasshme në <https://www.youtube.com/ëatch?v=IUkOYFQgg4Y&feature=youtu.be>

Insajderi, “Tribuna e mashtrimit – televizioni që u ka mbetur mijëra euro borxh dhjetëra punëtorëve”, 22 korrik 2018, qasur më 10 gusht 2018, <http://www.insajderi.com/hulumtime/tribuna-e-mashtrimit-televizioni-qe-u-ka-mbetur-mijera-euro-borxh-dhjetera-punetoreve/>

Ekonomia Online, “RTK-ja, që ankohet për mungesë të buxhetit, rrit numrin e punëtorëve”, Ekonomia Online, 19 korrik 2018. Qasur më 15 gusht 2018: <http://www.ekonomiaonline.com/nacionale/rtk-ja-qe-ankohet-per-mungese-te-buxhetit-rrit-numrin-e-punetoreve/>

E qasshme në <http://www.agk-ks.org/hasan-preteni-humb-betejen-ligjore-organizaten-cohu/>

